



PROGRAMI I PUNËS SË ORGANIZATËS TURISTIKE TË TUZIT PËR VITIN 2026

Numër: 01-330/25- 618

Tuz, 18.12.2025.

PËRMBAJTJA:

ANALIZA E GJENDJES AKTUALE	3
TREGUES STATISTIKORË	4
1. PËRMIRËSIMI DHE PASURIMI I OFERTËS TURISTIKE, ME RRIJTJEN E CILËSISË SË PRODUKTIT NË BAZË TË PARIMEVE TË ZHVILLIMIT TË QËNDRUESHËM.....	9
1.1. Krijimi i produktit turistik	9
1.2. Aktivitetet promovuese.....	9
1.3.Përmirësimi i regjistrimit të akomodimit privat.....	10
1.4. Organizimi i manifestimeve.....	11
2. POZICIONIMI I DESTINACIONIT TURISTIK NË TREG DHE TËRHEQJA E TURISTËVE ME FUQI MË TË MADHE BLERËSE PËRMES PROMOVIMIT TË PËRVOJAVE TË LLOJLLOJSHME.....	12
2.1. Webportali www.tuzi.travel, rrjetet sociale.....	12
2.2. Hartimi i materialit promovues, fotografik dhe video.....	12
2.3. Valorizimi i trashëgimisë kulturore	12
2.4. Pjesëmarrja në panaire.....	12
2.5. Info-pikat.....	12
2.6. Vizita studimore.....	12
3. ZHVILLIMI I KAPACITETEVE DHE MENAXHIMI MË CILËSOR I DESTINACIONIT.....	13
3.1. Realizimi i anketave.....	13
3.2. Bashkëpunimi me sektorin turistik, institucionet e kulturës dhe organizatat e tjera lokale turistike, si dhe bashkëpunimi me NTO të Malit të Zi.....	13
3.3. Sfida për zhvillimin e turizmit.....	12
3.4. Promovimi dhe implementimi i Markës së Cilësisë Montenegro Quality.....	14
4. KONTRIBUTI NË PARANDALIMIN E EKONOMISË GRI PËRMES INFORMIMIT, PROMOVIMIT DHE BASHKËPUNIMIT ME INSTITUCIONET PËRGJEGJËSE.....	14
4.1. Bashkëpunimi me institucionet.....	14
4.2. Fushata informuese.....	14

ANALIZA E GJENDJES AKTUALE

Organizata Turistike e Tuzit është themeluar në qershor të vitit 2019. Punëson gjashtë persona – katër me kohë të pacaktuar (referent, referent i lartë, këshilltar për çështje financiare dhe menaxher për turizëm), një person me kohë të caktuar dhe drejtorin.

Pavarësisht sfidave të caktuara, Organizata Turistike punon vazhdimisht në krijimin e produktit turistik, promovimin e vlerave dhe krijimin e një imazhi pozitiv të komunës.

Sipas të dhënave të Sekretariatit për Zhvillim Ekonomik dhe Projekte, në territorin e komunës së Tuzit janë të regjistruara rreth 40 objekte hotelierike.

Sa i përket kapaciteteve akomoduese, në këtë zonë ndodhen dy hotele: “Oasis” dhe “Liria”, me një kapacitet të përgjithshëm prej 93 shtretërish.

Tabela 1: Kapacitetet e hoteleve

Emri dhe lloji i objektit	Numri i dhomave	Numri i apartamenteve	Numri i shtretërve	Kategorizimi
HOTEL "OASIS"	20	10	60	4****
HOTEL I VOGËL "LIRIA"	15	1	33	3***

Nga të dhënat e Sekretariatit për Zhvillim Ekonomik dhe Projekte, për veprimtarinë e ofrimit të akomodimit është e regjistruar kjo kompani:

- Akomodim privat „Gjekë Sinishtaj”

Turizmi në komunën e Tuzit duhet të shihet përmes zhvillimit të turizmit natyror, sportiv dhe rural, me theks të veçantë mbi përjetimet aktive në natyrë, përmbajtjet rekreative dhe pushimin. Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet ngritjes dhe rregullimit të shtigjeve për ecje dhe biçikletë, të cilat do të mundësonin shfrytëzim më të mirë të resurseve natyrore dhe do të përmirësonin ofertën turistike.

Ofertën turistike të komunës së Tuzit është e nevojshme ta shqyrtojmë në kuadër të ofertës së integruar të rajonit më të gjerë, që përfshin edhe territoret e komunave fqinje. Në këtë mënyrë krijohet një produkt turistik i dallueshëm dhe një spektër më i gjerë programesh, aktiviteteve dhe llojesh të turizmit. Me rëndësi të veçantë është zhvillimi i bashkëpunimit ndërkufitar me Shqipërinë në fushën e turizmit, gjë që mund të kontribuojë në rritjen e konkurrueshmërisë dhe atraktivitetit të destinacionit.

Territori i komunës së Tuzit ka potencial të shprehur edhe për zhvillimin e turizmit tranzit, duke qenë se nëpër këtë komunë kalojnë rrugë magjistrale të rëndësishme: Podgoricë – Tuz – pika kufitare Bozhaj, që lidh Malin e Zi me Shqipërinë, dhe Podgoricë – Guci përmes territorit të Shqipërisë, që lidh veriun dhe jugun e Malit të Zi. Ky lloj turizmi nënkupton zhvillimin e mëtejshëm të përmbajtjeve përcjellëse turistike dhe infrastrukturës, në plotësim me kapacitetet ekzistuese.

Potenciali turistik i komunës së Tuzit

Potenciali turistik i komunës së Tuzit shprehet përmes pasurisë së resurseve natyrore, kulturore dhe shoqërore, të cilat së bashku përbëjnë bazën për zhvillimin e një oferte të larmishme dhe atraktive turistike.

Përparësitë kryesore të kësaj zone janë:

- pozita gjeografike e favorshme dhe afërsia me lumenjtë, detin, liqenet dhe malet
- resurset natyrore të ruajtura dhe peizazhe të llojllojshme
- pasuria me potenciale ujore
- mundësia e organizimit të tureve për ecje dhe ngjitje malore
- mundësia për t'u marrë me peshkim sportiv
- mundësia e vrojtimit të llojeve të rralla të shpendëve (birdwatching)
- ekzistenca e një pikë vrojtimi dhe mundësia për kajak në Liqenin e Shkodrës, si dhe për rafting në lumin Cem
- ekzistenca e kapaciteteve hoteliere dhe akomodimit privat të regjistruar
- multikulturaliteti dhe multietniciteti i pasur i popullsisë
- trashëgimi kulturo-historike i rëndësishme dhe traditë e ruajtur
- ekzistenca e Organizatës Lokale Turistike
- mikpritja tradicionale e popullsisë

TREGUES STATISTIKORË

Numri i ardhjeve dhe i netëqëndrimeve të realizuara sipas muajve për vitin 2022

Numri i përgjithshëm i mbërritjeve dhe netëqëndrimeve të realizuara sipas muajve					
		Mbërritjet e turistëve	Netëqëndrimet e turistëve	Indeksi i mbërritjeve	Indeksi i netëqëndrimeve
1	Janar	338	2980	5,39	4,38
2	Shkurt	421	3775	6,71	5,55
3	Mars	452	4741	7,20	6,98
4	Prill	596	6220	9,49	9,15
5	Maj	662	7999	10,55	11,77
6	Qershor	613	7154	9,77	10,53
7	Korrik	676	8577	10,77	12,63

8	Gusht	649	7592	10,34	11,18
9	Shtator	413	4194	6,58	6,17
10	Tetor	469	4733	7,47	6,97
11	Nëntor	623	6476	9,92	9,53
12	Dhjetor	362	3464	5,76	5,10
	TOTAL	6,274	67,905	100,00	100,00

Numri i ardhjeve dhe i netëqëndrimeve të realizuara sipas muajve për vitin 2023

Numri i përgjithshëm i mbërritjeve dhe netëqëndrimeve të realizuara sipas muajve					
		Mbërritjet e turistëve	Netëqëndrimet e turistëve	Indeksi i mbërritjeve	Indeksi i netëqëndrimeve
1	Janar	380	4626	7,70	7,75
2	Shkurt	350	3713	7,09	6,22
3	Mars	507	5504	10,27	9,22
4	Prill	445	4972	9,017	8,33
5	Maj	514	5834	10,41	9,78
6	Qershor	399	5085	8,08	8,52
7	Korrik	393	5891	7,96	9,87
8	Gusht	419	5374	8,49	9,00
9	Shtator	427	4932	8,65	8,26
10	Tetor	424	5192	8,59	8,70
11	Nëntor	368	4842	7,45	8,11
12	Dhjetor	309	3686	6,26	6,17
	TOTAL	4,935	59,651	100,00	100,00

Numri i ardhjeve dhe i netëqëndrimeve të realizuara sipas muajve për vitin 2024

Numri i përgjithshëm i mbërritjeve dhe netëqëndrimeve të realizuara sipas muajve					
		Mbërritjet e turistëve	Netëqëndrimet e turistëve	Indeksi i mbërritjeve	Indeksi i netëqëndrimeve
1	Janar	388	4223	7,78	6,90
2	Shkurt	354	3784	7,10	6,18
3	Mart	388	3764	7,78	6,15
4	Prill	537	7040	10,77	11,51
5	Maj	521	7196	10,45	11,76
6	Qershor	454	6962	9,11	11,38
7	Korrik	459	6164	9,12	10,08
8	Gusht	493	6154	9,89	10,06
9	Shtator	313	3426	6,28	5,60
10	Tetor	386	4433	7,74	7,25
11	Nëntor	436	4668	8,74	7,63
12	Dhjetor	254	3329	5,09	5,44
	TOTAL	4,983	61,143	100,00	100,00

Numri i ardhjeve dhe i netëqëndrimeve të realizuara sipas muajve për vitin 2025

Numri i përgjithshëm i mbërritjeve dhe netëqëndrimeve të realizuara sipas muajve					
		Mbërritjet e turistëve	Netëqëndrimet e turistëve	Indeksi i mbërritjeve	Indeksi i netëqëndrimeve
1	Janar	378	4451	9,67	8,85
2	Shkurt	328	3368	8,39	6,69
3	Mars	269	3289	6,88	6,54
4	Prill	524	6731	13,41	13,38
5	Maj	489	7000	12,51	13,91
6	Qershor	341	4975	8,73	9,89
7	Korrik	401	5324	10,26	10,58
8	Gusht	427	5751	10,93	11,436
9	Shtator	393	5086	10,06	10,11
10	Tetor	356	4313	9,11	8,57
11	Nëntor	/	/	/	/
12	Dhjetor	/	/	/	/
	TOTAL	3,906	50,288	100,00	100,00

Numri i mbërritjeve dhe netëqëndrimeve të realizuara sipas vendit të përkatësisë së turistëve për vitin 2025

Emri i vendit të përkatësisë	Mbërritjet e turistëve në komunë	Netëqëndrimet e realizuara në komunë	Mesatarja e gjatësi së qëndrimit në ditë	STRUKTURA në %		INDEX-I	
				Turistët	Netëqëndrimet	Turistët	Netëqëndrimet
EVROPA	3150	38184				90,80	87,04
Vendet jashtë Evropës	319	5684				9,19	12,95
TOTALI	3469	43868				100,00	100,00

Të ardhurat nga turizmi në vitin 2025

Të ardhurat	Të ardhurat e destinuara (EUR)			
	Të ardhurat nga taksa e qëndrimit	Indeksi i taksës së qëndrimit	Të ardhurat nga kontributi anëtarësor	Indeksi i kontributit anëtarësor
Janar	3.212,55	10,31		
Shkurt	2.115,45	6,79		
Mart	2.104,20	6,75		
Prill	5.004,45	16,06		
Maj	4.786,20	15,36		
Qershor	2.465,55	7,91		
Korrik	2.621,70	8,41		
Gusht	2.334,15	7,49		
Shator	2.835,90	9,105		
Tetor	2.409,30	7,73		
Nëntor	1.254,60	4,02		
Dhjetor				
TOTAL	31.144,05			

Të ardhurat nga turizmi në vitin 2024

Janar	3.116,70	8,27		
Shkurt	2.755,80	7,31		
Mart	2.619,00	6,95		
Prill	5.271,75	14,00		
Maj	4.338,90	11,52		
Qershor	4.171,50	11,07		
Korrik	2.463,30	6,54		
Gusht	2.784,15	7,39		
Shtator	1.846,50	4,90		
Tetor	2.894,40	7,68		
Nëntor	3.561,30	9,45		
Dhjetor	1.831,50	4,86		
TOTAL	37.654,80			

Të ardhurat nga taksat e qëndrimit, Organizata Turistike e Tuzit i realizon kryesisht nga punëtorët nga Shqipëria dhe rajoni.

Akomodimin privat e shfrytëzojnë ekskluzivisht punëtorët nga rajoni.

Të ardhurat nga taksat e qëndrimit OT e Tuzit i bashkon edhe nga 5 subjekte ekonomike, dhe ato janë:

1. "Plantacionet"
2. Visokogradnja MNE shpk
3. "Koja Company" shpk
4. "Vikriant" shpk
5. "Kopsaj" shpk

Analiza SWOT e Turizmit të Komunës së Tuzit

Pikat e forta

- Pozitë gjeografike e favorshme – afërsia me Podgoricën, Shqipërinë, Liqenin e Shkodrës dhe akset kryesore rrugore
- Burime natyrore të ruajtura (lumi Cem, Liqeni i Shkodrës, zonat malore)
- Multikulturalizëm dhe trashëgimi i pasur kulturor-historik
- Mikpritje tradicionale e popullsisë
- Afërsia me qendrën urbane (Podgorica) dhe aeroportin ndërkombëtar
- Pjesëmarrje në iniciativa rajonale dhe ndërkufitare

Mundësitë

- Zhvillimi i ekoturizmit, turizmit rural dhe sportiv
- Bashkëpunimi me komunat fqinje dhe forcimi i ofertës turistike rajonale
- Bashkëpunim ndërkufitar me Shqipërinë përmes projekteve të përbashkëta (programet IPA, fondet e BE-së)
- Zhvillimi i rrugëve turistike (shtigje këmbësorësh, biçikletash, rrugë vere, kulturore)
- Shfrytëzimi i potencialit të turizmit tranzit

Dobësitë

- Infrastrukturë turistike e pamjaftueshme (sinjalistikë, rrugë, zona pushimi, shtigje biçikletash dhe këmbësorësh)
- Kapacitete të kufizuara akomoduese dhe numër i vogël objektsh të kategorizuara
- Ofertë e pamjaftueshme e paketave turistike të organizuara dhe shërbimeve të guidave
- Mungesë e stafit të kualifikuar në fushën e turizmit dhe hotelerisë
- Investime të pamjaftueshme në turizëm dhe infrastrukturë

Kërcënimet

- Mungesa e një strategjie afatgjatë për zhvillimin e turizmit në nivel lokal
- Konkurrenca e komunave fqinje me infrastrukturë turistike më të zhvilluar
- Largimi i të rinjve dhe i kuadrit profesional nga komuna
- Burime të kufizuara financimi

PËRMIRËSIMI DHE PASURIMI I OFERTËS TURISTIKE, ME RITJEN E CILËSISË SË PRODUKTIT NË BAZË TË PARIMEVE TË ZHVILLIMIT TË QËNDRUESHËM

1.1. Krijimi i produktit turistik

1. **Pikë-nisja Nënham** ndodhet në territorin e Parkut Kombëtar të Liqenit të Shkodrës, 4 km nga qendra e Tuzit. Infrastruktura rrugore është shumë e mirë, dhe gjatë pjesës më të madhe të vitit ka ujë burimi. Pikërisht nga kjo pikë nis shtigji malor Hum, me lartësi 276 m. Zona ofron kushte të shkëlqyera për zhvillimin e turizmit rekreativ dhe sportiv, vëzhgimin e shpendëve (afër ndodhet rezervati Syni i Pacit), si dhe për njohjen me kulturën lokale.
Planifikohet vendosja e sinjalizimit turistik drejt rezervatit Syni i Pacit, i cili ndodhet 2 km larg Nënhami

Organizata Turistike e Tuzit, në bashkëpunim me komunën dhe banorët, ka filluar rregullimin e pikës së nisjes, zgjerimin e rrugës dhe nisjen e punimeve për ndërtimin e një pikë-vëzhgimi mbi themelet e urës së vjetër që lidh Nënhamin dhe Samoborin. Nënhami është 2 km larg rezervatit Syni i Pacit.

Afati: tremujori II–III

Treguesi: Vendosja e sinjalizimit turistik

Rezultati: Krijimi i një produkti turistik për rritjen e vizitueshmërisë

2. **Zbeq** – OT ka filluar punimet për krijimin e kushteve për pastrimin e kanalit që çon drejt Liqenit të Shkodrës dhe që është ideal për vëzhgimin e shpendëve dhe lundrimin me barkat turistike. Në bashkëpunim me komunën është thelluar kanali. OT do të vazhdojë promovimin e këtij vendi gjatë vitit 2026 përmes manifestimeve.
Zbeqi është 4 km larg rezervatit Syni i Pacit.

Afati: tremujori II–III

Treguesi: Promovim përmes të paktën një manifestimi

Rezultati: Krijimi i produktit turistik për rritjen e vizitueshmërisë

3. **Vitoja** – pikë rekreative në Liqenin e Shkodrës, e promovuar nga OT. Është vendosur një stol panoramik afër saj. Në bashkëpunim me Komunën e Tuzit është bërë promovimi përmes aktiviteteve dhe manifestimeve të ndryshme, veçanërisht gjatë sezonit veror. OT do të vazhdojë aktivitetet në rregullimin e këtij lokaliteti, sinjalizimit dhe hapësirave për qëndrim të turistëve.

Afati: tremujori I – IV

Treguesit:

- Vendosja e sinjalizimit turistik në Vitojë

- Mundësimi i përdorimit të kajakëve në Nënhelm dhe Vitojë
- Organizimi i të paktën një manifestimi

Rezultati: Krijimi i produktit turistik për rritjen e vizitueshmërisë

4. **Karnavali në Tuz** përfaqëson të vetmin karnaval të dallueshëm në pjesën qendrore të Malit të Zi. Tuzi gjendet në listën e qyteteve të karnavaleve, ndërsa manifestimi çdo vit tërheq numër të madh vizitorësh dhe pjesëmarrësish, duke kontribuar në promovimin e identitetit kulturor dhe ofertës turistike të zonës.

Afati: tremujori I

Treguesi: Rritja e numrit të vizitorëve për 200 persona

Rezultati: Krijimi i produktit turistik për rritjen e vizitueshmërisë

5. **Lumi Cem** është një nga perlët natyrore më të njohura të Tuzit dhe gjithë rajonit qendror të Malit të Zi. I njohur për kanionet, ujëvarat dhe natyrën e paprekur, Lumi Cem është ideal për zhvillimin e turizmit. Qëllimi është pozicionimi i tij si produkt turistik i njohur që bashkon bukuritë natyrore, përmbajtjet rekreative dhe vlerat kulturore të zonës.

Afati: tremujori II–III

Treguesit:

- Rritja e numrit të vizitorëve dhe turistëve
- Përgatitja e materialit promovues

Rezultati: Krijimi i produktit turistik për rritjen e vizitueshmërisë

1.2. Aktivitetet promovuese

1. Promovimi online

Vazhdohet puna në përmirësimin e përmbajtjes dhe inovacionit në postimet në rrjetet sociale (Facebook dhe Instagram), me qëllim forcimin e promovimit digjital të Tuzit. Planifikohet promovimi i shtigjeve për ecje, Lumit Cem dhe lokacioneve të tjera atraktive, si dhe paraqitja e potencialeve të fshehura të kësaj zone.

Gjatë vitit 2025 janë organizuar vizita të gazetarëve ("Bukuritë e egra të Malit të Zi") dhe influencuesve, me qëllim rritjen e dukshmërisë.

OT e Tuzi ka shpallur konkurs publik për të rinjtë e Tuzit me temën "Bukuritë natyrore të komunës sime", me detyrë krijimin e një video-materiali për përdorim promovues.

Organizata Turistike e Tuzit ka formuar edhe grupin e mazoretëve që merr pjesë në promovimin e ngjarjeve turistike dhe kulturore.

Afati: I–IV (vazhdimisht)

Treguesit:

- Rritja e ndjekësve në rrjetet sociale me 20%
- Realizimi i aktiviteteve promovuese në faqen zyrtare

Rezultati: Zhvillimi i identitetit turistik të Tuzit

1.3. Përmirësimi i regjistrimit të akomodimit privat

OT e Tuzit, në bashkëpunim me sekretariatën kompetent, do të realizojë një fushatë të orientuar drejt regjistrimit të akomodimit privat.

Afati: vazhdimisht

Treguesi: rritja e numrit të akomodimeve të regjistruara dhe evidencë e përmirësuar e turistëve

Rezultati: rritje e numrit të akomodimeve private të regjistruara

1.4. Organizimi i manifestimeve

Varësisht nga burimet financiare gjatë vitit 2026, do të organizohen manifestime që përfshijnë artizanë lokalë, gra, të rinj dhe persona me nevoja të veçanta. Qëllimi është forcimi i komunitetit dhe promovimi i traditës.

OT e Tuzit do të vazhdojë organizimin e manifestimeve që pasurojnë ofertën turistike.

Manifestimet e planifikuara:

1. **Ditët e Cemit** – afër lumit Cem; regatë me kajak, ture biçiklete, ecje. Promovim i ekoturizmit dhe pushimit aktiv.
2. **Festivali i vjeshtës / Produktet e rrushit / Festa e kungullit** – përfshin artizanë të rinj, gra në zanate dhe bujqësi, panair të produkteve bujqësore.
3. **Turneu amator i tenisit** – aktivitet sportiv për të gjitha grupmoshat.
4. **Regata me kajak në Vitojë dhe Nënhelm** – promovon dy pika turistike të rëndësishme.
5. **Shtigjet tona** – ture edukative, promovuese dhe sportive.

Në bashkëpunim me Komunën Tuzi:

- Vera në Malësi
- Panairi dimëror
- Dita Ndërkombëtare e Gruas
- Old Timer Fest

Me banorët e Trieshit:

- Expo Trieshi – panair tradicional i produkteve

Afati: I–IV

Treguesit:

- Pjesëmarrje aktive e artizanëve lokalë, grave, të rinjve
- Rritja e vizitorëve për 10%
- Bashkëpunim me OJQ dhe komunitete lokale
- Fushatë e realizuar promovuese
- Rritje e dukshmërisë së Tuzit

Rezultati: Forcimi i identitetit turistik të Tuzit si komunë ndërkufitare

2. POZICIONIMI I DESTINACIONIT TURISTIK NË TREG DHE TËRHEQJA E TURISTËVE ME FUQI MË TË MADHE BLERËSE PËRMES PROMOVIMIT TË PËRVOJAVE TË LLOJLLOJSHME

2.1. Webportal www.tuzi.travel, rrjetet sociale

Dukshmëria e Tuzit është rritur në mënyrë të konsiderueshme gjatë vitit 2025. Është në përfundim faqja e re zyrtare e OT të Tuzit dhe së shpejti do të lansohet aplikacioni mobil “I Love Tuzi”.

Gjatë 2026 OT e Tuzit do të vazhdojë me aktivitete promovuese dhe paraqitje mediatike.
Afati: vazhdimisht
Treguesi: forcimi i dukshmërisë së ofertës turistike

2.2. Përgatitja e materialit promovues, foto dhe video

Planifikohet krijimi i broshurave, hartave turistike dhe suvenireve gjatë vitit 2026.
Afati: vazhdimisht
Treguesit: broshura të turizmit aktiv, harta turistike, suvenire me karakter historik dhe kulturor

2.3. Valorizimi i trashëgimisë kulturore

Në bashkëpunim me Komunën Tuzi, në përputhje me nenin 8 të Ligjit për taksën e qëndrimit, shpallet thirrja publike për projekte mbështetëse në turizëm.
Afati: tremujori III–IV
Treguesi: të paktën një projekt i realizuar

2.4. Pjesëmarrja në panaire

OT Tuz duhet të marrë pjesë në të paktën 3 panaire në rajon, në bashkëpunim me OTL tjera dhe ONT të Malit të Zi.
Afati: vazhdimisht
Treguesi: pjesëmarrja në tre panaire

2.5. Info-punktet

Gjatë sezonit veror nevojitet hapja e info-pikave ku turistët mund të marrin informacione.
Afati: maj–shtator 2026
Treguesi: funksionimi i një info-punkti në Vitojë/Niagara, Tuz

2.6. Vizitat studimore

Vizitat e gazetarëve, turoperatorëve dhe influencuesve janë shumë efikase për promovimin e destinacionit.

Afati: gjatë 2026

Treguesi: të paktën dy vizita të realizuara

3. ZHVILLIMI I KAPACITETEVE DHE MENAXHIMI MË CILËSOR I DESTINACIONIT

3.1. Realizimi i anketave

Do të shqyrtohet mundësia e kryerjes së anketave mbi kënaqësinë e turistëve dhe sektorit privat.

Afati: 2026

Treguesi: të paktën një anketë e realizuar

3.2. Bashkëpunimi me sektorin turistik, institucionet e kulturës dhe organizatat e tjera lokale turistike, si dhe bashkëpunimi me NTO të Malit të Zi

Me qëllim të harmonizimit të programeve dhe promovimit më të mirë të ngjarjeve në territorin e Komunës së Tuzit, Organizata Turistike e Tuzit do të iniciojë bashkëpunim me QIK “Malësia” Tuz, Sekretariatit për Vetëqeverisje Lokale, Sekretariatit për Zhvillim dhe Projekte, ndërmarrjen sh.p.k. “Komunalno/Komunale”, sh.p.k. “Monumenti i Natyrës Kanioni i Cemit”, si dhe me organizata të tjera lokale turistike, me qëllim forcimin e promovimit dhe zhvillimin e një produkti të përbashkët turistik.

Vëmendje e veçantë do t’i kushtohet bashkëpunimit me Organizatën Nacionale Turistike të Malit të Zi (ONT të MZ), përmes aktiviteteve të përbashkëta promovuese, pjesëmarrjes në fushata turistike kombëtare dhe ndërkombëtare, panairë dhe manifestime, si dhe përmes shkëmbimit të informacionit, mbështetjes marketingu dhe përfshirjes së ofertës turistike të Komunës së Tuzit në programet promovuese të Malit të Zi.

Afati i realizimit: Tremujori III dhe IV i vitit 2026

Indikatori: Projekte të realizuara në bashkëpunim me sektorin turistik, institucionet e kulturës dhe organizatat e tjera lokale turistike (LTO), si dhe me NTO e Malit të Zi.

3.3. Sfidat e zhvillimit të turizmit

Sfidat kryesore janë:

- mungesa e kapaciteteve hoteliere dhe fshatrave etnografike
- mungesa e ofertës së organizuar turistike
- qasja e parregulluar në liqen dhe mungesa e plazheve të rregulluara
- objektet hotelierike të pakategorizuara
- sinjalizim i pamjaftueshëm
- mungesa e stafit të specializuar turistik

Afati: I–IV 2026

Treguesit:

- vendosja e sinjalizimit turistik
- trajnimi i një udhërrëfyesi turistik nga zona
- rregullimi i të paktën një plazhi
- rritja e aktiviteteve promovuese

3.4. Promovimi dhe implementimi i Markës së Cilësisë Montenegro Quality

Organizata Turistike e Tuzit do t'i kushtojë vëmendje të veçantë bashkëpunimit me Organizatën Nacionale Turistike të Malit të Zi (ONT të MZ) në promovimin dhe implementimin e markës së cilësisë **Montenegro Quality**. Me këtë qëllim, Organizata Turistike e Tuzit do të promovojë në mënyrë aktive, pranë subjekteve ekonomike në territorin e Komunës së Tuzit, fshatrave etno dhe lokaliteteve të tjera turistike, rëndësinë dhe përparësitë e përfshirjes në sistemin e markës së cilësisë Montenegro Quality, do të ofrojë mbështetje në procesin e informimit dhe do të motivojë ofruesit e shërbimeve që të përmirësojnë cilësinë e ofertës së tyre në përputhje me standardet e përcaktuara.

Afati i realizimit: Tremujori I–IV i vitit 2026

Indikatorët: Projekte të realizuara, minimumi 3

4.KONTRIBUTI NË PARANDALIMIN E EKONOMISË GRI PËRMES INFORMIMIT, PROMOVIMIT DHE BASHKËPUNIMIT ME INSTITUCIONET

4.1. Bashkëpunimi me institucionet

OT e Tuzit, në bashkëpunim me Policinë Komunale të Tuzit dhe organet e tjera shtetërore, do të vazhdojë kontrollet dhe mbështetjen për regjistrimin e objekteve hotelierike dhe akomodimit privat dhe në luftën kundër ekonomisë gri.

Forcimi i bashkëpunimit të deritanishëm mbetet prioritet edhe në vitin 2026.

4.2. Fushata informuese.

Fushata kundër ekonomisë gri do të promovohet në rrjetet sociale të OT të Tuzit; do të shqyrtohet mundësia e përgatitjes së broshurave me qëllim informimi dhe edukimin e sipërmarrësve lokalë.

Në përputhje me mundësitë financiare dhe realizimin e të ardhurave gjatë vitit 2026 planifikohet organizimi i të paktën një fushate informuese të dedikuar subjekteve ekonomike lokale në Komunën e Tuzit.

**DREJTORI
ALEN GJOKAJ**

